



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Zhalbe i Predstavke

Anr. 180/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Zyndi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendlodhi përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendlodjes së posterit në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa A.nr. 180/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike - vendlodjes së posterit në Rr. "Zahir Pajaziti", në qytetin e Besianës i SHQIPOHET gjobë në lartësi prej 2,700.00 (dymijë e shtatëqind) euro, dhe Detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 02.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.180/2019, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilat pretendohet se nga ana e aktivistëve të LVV-së, qendra në Besianë, rrëth orës 15:10, në Rr."Zahir Pajaziti", në qytetin e Besianës, është vërejtur një shtand dhe një poster i kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), Floretë Zejnullahu, i vendlodhi në hapësirë publike, veprim ky i cili sipas subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), bie në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, përkatesisht nenin 33 pikë b), dhe me Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2013.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi të printuara, në cilësi të provave materiale.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.10.2019, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka theksuar se për vendlodjen e shtandit dhe posterit në vendin sic pretendon paraqitësi i ankesës, subjekti politik PDK, ka ndërmarrë masa përmirësuese, duke larguar këtë material zgjedhor nga vendi ku pretendohet se është bërë shkelja, duke bashkangjitur një deklaratë të Floretë Zejnullahut dhe një fotografi të printuar, në cilësi të provës materiale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 2, të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është ngjitur në hapësirë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b), të LZP-së, e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”. Duke u nisur nga gjendja faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është shkelur neni 33 pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik PDK, është vendosur në hapësirë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me Rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti posteri i kandidates për deputete të këtij subjekti politik është vendosur në hapësirë publike.

Si rrrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që subjekti politik PDK, në përgjigjen në ankesë, ka deklaruar se janë marrë masa përmirësuese, ku është përmirësuar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje të ankesë. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit 3 paragrafi 2 i Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, për shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund të shqiptohet gjobë në lartësi nga 5,100.00 euro deri në 20,000.00 euro, mirëpo siç u konstatua me lart, veprimet e subjektit politik PDK, për ta përmirësuar shkeljen, kanë ndikuar në uljen e lartësisë e gjobës.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1, pika c) dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë
Anr.180/2019 më datë 04.10.2019

Kryesues i Panelit
Bruslem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.